REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, MARS 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	25.2.2025	Kërkohet informacion mbi: - Çfarë masash konkrete janë zbatuar nga ana e qeverisë për shfuqizimin e padive penale dhe civile ndaj gazetarëve?Të dhënat e padive kundër gazetarëve që nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)? - Çfarë hapash ka ndërmarrë qeveria për të siguruar rinovimin e marrëdhënieve me median dhe eliminimin e presioneve dhe favorizimeve? - A ka raste të dokumentuara ku organizata të medias, gazetarë apo shoqëria civile ka ngritur shqetësime për presione nga ana e qeverisë nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)? Çfarë masash ka marrë qëveria në ato raste? - Si e ka forcuar qeveria të drejtën e informimit për gazetarët? Ju lutemi jepni detaje për çdo standard të ri ligjor ose ndryshim të bërë që nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)? - A është bërë një raport apo auditim në lidhje me funksionimin e faqeve zyrtare të internetit të institucioneve publike dhe ministrive? Nëse po, ju lutemi jepni gjetjet. - Si është siguruar qeveria që gazetarët dhe qytetarët të kenë akses në informacion nga administrata publike? - Çfarë nismash ligjore janë ndërmarrë për uljen e gjobave ndaj gazetarëve dhe cilat janë rezultatet specifike të këtyre nismave nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)? - A mund të kem një raport krahasuese të gjobave ndaj gazetarëve para dhe pas masave të propozuara të uljes? - Çfarë ndryshimesh konkrete janë bërë në ristrukturimin e RTSH për të siguruar funksionimin e saj si transmetues publik? - Si është garantuar pavarësia e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe RTSH që nga fillimi i reformave? - Cilat janë kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së? - Cilat programe specifike mbështetëse ose mekanizma financimi janë krijuar për të ndihmuar mediat lokale që nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)?	6.3.2025	Në përgjigje të kërkesës, informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, studime, etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
2	28.2.2025	Kërkohet numri i fluturimeve të kryera nga secili anëtar i Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2024? - Cilat kanë qenë destinacionet përkatëse të këtyre fluturim. S aështë kosto totale financiare të fluturimeve të realizuara nga secilianëtar i Këshillit të Ministrave? Sa është koston totale të akomodimit për anëtarët e Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2024 për udhëtimet e kryera? Ju lutem kosto totale të paraqitet ndaras për secilin anëtar. - Cilët kanë qenë ofruesit e shërbimeve të akomodimit (hotele apo njësi të tjera pritëse)?	6.3.2025	Informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, për të dhënë sqarime, për t'ju përgjigjur pyetjeve etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa juaj duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet. Gjithashtu dëshiroj t'ju informoj se bazuar në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", neni 3, përcakton se: "1. Kryeministria është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit", ndërsa sipas nenit 4, "Kryeministria përfshin: aparatin e Këshillit të Ministrave, kabinetin e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendëskryeministrit dhe kabinetin e Ministrit të Shtetit. Pra, ministrat e shtetit së bashku me kabinetet përkatëse janë pjesë e strukturës dhe organikës së Kryeministrisë, ndërsa buxhetet vjetore të tyre janë pjesë përbërëse e buxhetit të Kryeministrisë dhe gjenden në ligjin për buxhetin e shtetit, sipas viteve respektive. Pra, për informacionin që lidhet me ministritë, kërkesën duhet t'i dërgohet autoriteteve publike përkatëse (ministrive).	Përfunduar	Nuk ka
3	12.3.2025	Në kuadër të miratimit të vendimit nr. 151, datë 6.3.2025 "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line "Tiktok", kërkohet çdo dokumentacion që është administruar në kuadër të miratimit të kësaj VKM-je.	16.3.2025	Deleguar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka